



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Berat, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PROCESVERBALI I ARGUMENTIMIT DHE MIRATIMIT TE SPECIFIKIMEVE  
TEKNIKE DHE TE KRITETREVE TE KUALIFIKIMIT.**

I mbajtur sot, me datë 11.03.2024, nga njësia e prokurimit e ngritur me urdhërin nr.2, Nr.135/5 Prot dt 08.03.2024 .

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Materiale asfaltimi”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**44113100-6 “Materiale asfaltimi”, 44113620-7 “Asfalt”**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 39.999.848.00 ( *tridhjetë e nente milion e nentëqind e nentëdhjetë e nente mijë e tetëqind e dyzet e tete* ) **LEK PA TVSH****

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM Nr. 710 dt 24.11.2021, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Publike Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Shtojca 7**

**I.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk

është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

**Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.**

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë **verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim

**Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.**

**Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.**

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

*a. Formularin e Ofertës dhe lista e çmimeve sipas Shtojcës 1-2.*

*b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Kriteret (a-c) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”**

**Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës dhe listen e çmimeve, sipas Shtojcës 1-2.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar sipas VKM 710 dt 24.11.2021, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*b.Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

**Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.**

**Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:**

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

### **c. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

#### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

##### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore,** të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit ( **2020, 2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:

**Pika 1.** Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

**Pika 2/b:** Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; **Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;** Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **bilancet vjetore**, për vitet financiare ( **2020, 2021,2022**), ne perputhje me *nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore*

## Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 **Për të provuar përvojën e mëparshme**, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **15.999.939.2 (pesëmbëdhjete milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nënte mijë e nëntëqind e tridhjetë e nënte, pikë dy ) leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet)**, që është realizuar **gjatë tri viteve të fundit** nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a- **Vërtetime të lëshuara nga një ent publik** ku shënohen **datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes**, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore **ose**
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar **me sektorin privat**, si dëshmi pranohen **vetëm fatura tatimore të shitjes**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

### **Argumentimi: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetur nepermjet pervojes se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

## **2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, në momentin që do lëvrohet malli prane Autoritetit Kontraktor.**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne perputhje me nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku citohet: "dëshmi për rezultatet e testimet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ne rastin konkret, kemi te bejme me nje kerkese minimale, per nje dokument cilesie per materialet qe autoriteti kontraktor, kerkon te bleje.

*Persa me siper kerkohet nje dokument certifikues i cilesise, pra ne perputhje me nenin 77, ligji nr.162, date 23.12.2021. dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara, që kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, sipas zerave të preventivit, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, pasi janë lehtësisht të sigurueshme, me kosto të ulët, si dhe plotësueshme nga cdo operator që është në gjendje dhe do të realizojë një furnizim si ai që kërkon objekti të kontratës.*

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues **duhet të ketë kontratë të vlefshme me një laborator testimi** të materialeve Asfaltobeton guri kave, Bitum M-3 dhe Binder me granil guri kave, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet: *”dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”*

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht:

-3( tre ) Shoferë për kamiona (kategoria C minimale),

Për të cilët, duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente. **Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton kapacitetin të profesional stafin, personelin e nevojshëm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë staf për realizimin e furnizimit me mallrat e kërkuara për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me furnizimin e mallrave që kërkojnë të realizohen të cilat janë ndertimore, etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

**2.3.4** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te provojne se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, asfaltobeton, binder, bitum për sa me sipër duhet të paraqesë dokumentacionin për: **Fabrik Asfalti me QKL në Pronësi / kontrate noteriale qeraje / kontrate noteriale furnizimi.**

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësive, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

**QKL - Fabrike asfalti – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorise së Përgjithshme të Akreditimit të paktën 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**

Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale ose kontrate noteriale qeraje (kjo kontratë duhet të jetë vlefshme për periudhën e zhvillimit të prokurimit.)

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me, nenin 77, pika 4, ligji nr.162, datë 23.12.2021 pasi bëhet mundur dhe garanton, përputhshmerinë dhe rregullsinë e procesit të furnizimit, cilësinë e produktit si dhe disponibilitetin e mallit me cilësinë e kërkuar, për gjatë ekzekutimit të kontratës. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. nenin 77, pika 4, ligji nr.162, datë 23.12.2021. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Referuar vkm nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **përzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.** Referuar nenin 2 gërma “b” “qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se; “qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës.

**2.3.5** Me qëllim realizimit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 3 ( tre) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,
- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse. Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontratë e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.



**Per mjetet e transportit per mallrat te klasifikuar sipas legjislacionit ne fuqi te rrezikshme (Autobitumatriçe) duhet te paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse ( e vlefshme).**

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me **qëllim verifikimi** nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë nga moment i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar si më sipër. **Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik , do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatave te ankimit.**

**Argumentimi:**ky kriter u vendos ne perputhje me neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2020 në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne rastin konkret jane kerkuar :

- *minimalisht 3 (tre ) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,*
- *minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe*

Ne referim te:

- llojit te materialit,
- procesit teknik te furnizimit,
- sasise se kerkuar,
- afatit te kerkuar, si dhe mundesise teknike te vendosjes ne veper.

Sa mesiper kemi te bejme me kritere minimale per plotesimin dhe realizimin e kontrates sipas percaktimeve dhe qellimit te saj.

Nr	analize	Emertimi	Njesia	Sasia
1		Bitum M-3	kg	19080

		(leng)		
2		Binder me granil guri kave	ton	2400
3		Asfaltobeton guri kave	ton	1424

Sa me sipër është marrë parasysh sasitë e kerkuara, si procesit teknik të furnizimit, dhe ai i vendosjes, pasi nuk janë mallra që mund të magazinohen, si dhe nuk janë mallra që mund të rrinë në gjendje magazinimi, nga vet **natyra fizike** e tyre (binder, asfaltobeton), por menjehere pas procesit të prodhimit ngakohen në mjet, dhe dergohen në vendin e vendosjes në veper.

Referuar vkm nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **...përzierja e prodhuar (binder, asfaltobeton) duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.** Sa më sipër llogaritja është mbështetur dhe me mundësinë autoritetit kontraktor për vendosjen në veper, në sinkronizim me prodhim-furnizim të mallrave binder, asfaltobeton).

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose **ekuivalente të tij.**

Çertifikata e mesiperme të jete në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. *Çertifikata e mesipërme kërkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO 9001-2015 sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a, nenin 79 të LPP, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë kërkuar këto certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe sistemi i menaxhimit mjedisor . Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) i përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallrat që plotësojnë kërkesat e sandarteve të cilësisë..*

*Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

**2.3.7 Deklarate nga Operatori ekonomik Fitues ku merr persiper qe te deklaroj se transporti I mallrave objekt prokurimi do realizohet me shpenzimet e veta sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne perputhje me grafikun e vendosur nga Autoriteti Kontraktor.**

**Argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale** ( pajisjet, makineritë, punonjësit dhe profilet e tyre të punës janë mirë argumentuar nga specialisti fushës pjesë e njësisë së prokurimit Arkitekt Iris Hoxhallari.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë vendosur nga specialisti i fushës Iris Hoxhallari, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”,nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE TE MATERIALEVE TE KERKUARA**

#### **1. ASFALTO BETON GUR KAVE.**

Duhet të jetë i përgatitur nga lëndët lidhëse bitum, cakull në masën 40% dhe rere në masën 60%.Te jetë I prodhuar nga material gurorë i thyer me permasat nga 5-20mm. me përmbajtje bitumi jo më pak se 4.5%,densiteti 2.2gr/cm<sup>3</sup>dhe bitum 50 70.Materiali i gurit që do të përdoret për granilin e gurit, . Temperatura e Asfaltit në në momentin e hedhjes në objekt duhet të jetë 150 grade.Në përzierjen e gatshme të asfalto betonit nuk lejohet të ketë kokrriza të pa mbuluara me bitum. Bitumi që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit si dhe në asfaltimet e tjera me depertim ose trajtim sipërfaqësor, duhet të plotësojë kërkesat e Stash 660-87 ose të STASH CNR Nr. 1996 Karakteristika për praninë”. Në kohë të nxehtë (verë) keshillohet përdorimi i bitumit me depertim (penetrim) 80 deri 120 ose me pike zbutje 45 deri 50°C, ndërsa në pranverë e vjeshtë bitum me depertim 120 deri 200 ose pike zbutje 40 deri 45°C.

*Argumentim : Specifikimet e këtij malli vendosen në referim të DPS (STASH).*

2. **BITUME M-3** Duhet të jetë çilesore me një dozim 3.8 për m<sup>2</sup> dhe i zbatuar në të nxehtë.Te hollohet me 20/30 % uji.

3. **BINDER** Duhet të jetë i përgatitur nga lëndët lidhëse bitum, cakull në masën 60% dhe rere në masën 40%.Te jetë I prodhuar nga material gurorë i thyer me permasat nga 5-20mm. me përmbajtje bitumi jo më pak se 4.5%,densiteti 2.2gr/cm<sup>3</sup>dhe bitum 50 70.Materiali i gurit që do të përdoret për granilin e gurit, . Temperatura e Asfaltit në në momentin e hedhjes në objekt duhet të jetë 150 grade.Në përzierjen e gatshme të binderi nuk lejohet të ketë kokrriza të pa mbuluara me bitum. Bitumi që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit si dhe në asfaltimet e tjera me depertim ose trajtim sipërfaqësor, duhet të plotësojë kërkesat e Stash 660-87 ose të STASH CNR Nr. 1996 Karakteristika për praninë”. Në kohë të nxehtë (verë) keshillohet përdorimi i bitumit me depertim (penetrim) 80 deri 120 ose me pike zbutje 45 deri 50°C, ndërsa në pranverë e vjeshtë bitum me depertim 120 deri 200 ose pike zbutje 40 deri 45°C.

*Argumentim : Specifikimet e këtij malli vendosen në referim të DPS (STASH) dhe janë realizuar nga specialist i fushës.*

*Grafiku I levrimit të mallrave*

Nr	analize	Emertimi	Njesia	Sasia
1		Bitum M-3 (leng)	kg	19080
2		Binder me granil guri kave	ton	2400
3		Asfaltobeton guri kave	ton	1424

*Argumentim :Sipas kerkeses se bere nga pergjegjesi.*

Kriteri i vleresimit **Oferta me e ulët e vlerësuar**

Data e zhvillimit te tenderit do të jetë data 01.04.2024.

Të njihet menjëherë, K.V.O. me dokumentat e tenderit për këtë procedure prokurimi. Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik për shpallje dhe botim nga APP.

**Njesia e prokurimit**

**Miratohet**

**Roland Deda Personi Pergjegjes**  
**Brikena Halitaj Specialiste finance**  
**Iris Hoxhallari Specialist i Fushes**

**Titullari i Autoritetit kontraktor**  
**Bledar ÇILI**